

Procesverbal - Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i procedurës: “Blerje Depozite uji 5000 L”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kontenierte uji 44613500-5

Vlera e fondit limit: 3.285.000 (tre milion e dyqind e tetëdhjetë e pesë mijë lekë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar me VKM-në nr.714, datë 24.11.2021 autoriteti/enti kontraktor UKT sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;përkatësisht në 65.700 (gjashtë e pesë mijë e shtatë qind) lekë

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe nenit 19, pika 2, të VKM Nr. 498, datë 1.8.2024 për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të këshillit të ministrave, “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK”, të ndryshuar.

2.2.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2026, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006.

”Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar; **(lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njesitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2026).**

(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit

duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2025 sipas kësteve të parashikuara në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 si dhe vendimeve respektive të Këshillave Bashkiakë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2025 sipas kësteve prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3. Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara

sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar si kompani sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- a) Certifikatë **ISO 9001:2015** (ose ekuivalente) mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim; (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zerave që do të marrë persiper sipas akt-marreveshjes).
- b) Certifikatë **ISO 14001:2015** (ose ekuivalente) “Sistemet e menaxhimit të mjedisit” lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim; (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zerave që do të marrë persiper sipas akt-marreveshjes).
- c) Certifikatë **ISO 45001:2018** (ose ekuivalente) mbi “Shëndetin dhe siguria në punë” lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim; (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zerave që do të marrë persiper sipas akt-marreveshjes).

Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.

Argumentimi Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

ISO 9001(ose ekuivalente) parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencen/profesionalizmin e punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimit të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Certifikimi ISO 14001 :2015 (ose ekuivalente) është vendosur me qëllim garantimin që operatori ekonomik zbaton standarde të njohura ndërkombëtarisht për menaxhimin mjedisor, duke siguruar kontrollin e ndikimeve mjedisore që lidhen me aktivitetin e furnizimit, mirëmbajtjes dhe servisimit të automjeteve. Ky standard garanton respektimin e legjislacionit mjedisor, menaxhimin e sigurt të mbetjeve teknike dhe reduktimin e rreziqeve mjedisore, duke kontribuar në realizimin e kontratës sipas parimeve të eficiencës, sigurisë dhe përgjegjshmërisë mjedisore."

Kërkesa për paraqitjen e certifikatës ISO 45001:2018 është e justifikuar pasi garanton që operatori ekonomik ka zbatuar një sistem të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, në përputhje me standardet ndërkombëtare. Ky standard synon identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin e rreziqeve në vendin e punës, parandalimin e aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale, si dhe sigurimin e kushteve të sigurt për punonjësit.

Kjo kërkesë është veçanërisht e rëndësishme për kontrata ku realizimi i shërbimeve ose punimeve përfshin aktivitete operative, punë në terren ose ekspozim ndaj rreziqeve profesionale. Pajisja me këtë certifikatë dëshmon se operatori ekonomik ka kapacitetet organizative dhe procedurat e nevojshme për të menaxhuar në mënyrë efektive çështjet e shëndetit dhe sigurisë në

punë, duke minimizuar rreziqet gjatë zbatimit të kontratës dhe duke garantuar respektimin e legjislacionit në fuqi.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet te paraqese:

Autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi për mallrat e kërkuara në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi për shqipërinë OE duhet të paraqesë dokumentacionin për të vërtetuar lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentim: : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020, neni 73 datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar neni 40, pika 6, germa “c”, i jep mundësinë autoriteteve kontraktorë t’u kërkojnë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

Njësia e Prokurimit gjykon se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesit ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi është në përputhje dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi.

Pra nëpërmjet vendosjes së kriterit të sipërpërmendur AK garantohet dhe fiton siguri se operatori ekonomik kontraktues do të furnizojë dhe do të përmbushë kontratën me sukses.

Për autoritetin është e rëndësishme që të sigurohet “mall” sipas standarteve të kërkuara, specifikimeve teknike, e gjithashtu dokumentacioni i kërkuar për tu paraqitur është i parashikuar dhe brenda kuadrit ligjor të parashikuar në dispozitat ligjore.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentim Teknik mbi Specifikimet Teknike

Në zbatim të nenit 36 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar, specifikimet teknike janë hartuar në funksion të nevojave konkrete të Autoritetit Kontraktor dhe kanë si qëllim garantimin e funksionalitetit, jetëgjatësisë, sigurisë në përdorim dhe përputhshmërisë së pajisjes me kushtet teknike të instalimit dhe shfrytëzimit.

Specifikimet teknike janë përcaktuar mbi bazën e karakteristikave minimale të nevojshme, pa kufizuar konkurrencën, duke lejuar ofertimin e produkteve nga prodhues të ndryshëm që plotësojnë këto kërkesa.

Argumentimi për secilin parametër teknik:

- **Kapaciteti: $V = 5,000$ litra**
Kapaciteti prej 5,000 litrash është përcaktuar në funksion të nevojës për të siguruar rezervën e nevojshme të ujit për përdorim operacional, duke garantuar furnizim të pandërprerë gjatë intervaleve të konsumit ose në rast ndërprerjesh të përkohshme të furnizimit.
- **Tipi: Vertikale**
Depozita vertikale optimizon shfrytëzimin e sipërfaqes së instalimit, zë më pak hapësirë horizontale, lehtëson mirëmbajtjen dhe siguron shpërndarje më të mirë të ngarkesës statike mbi bazament.
- **Diametri: $D = 1,600$ mm**
Diametri është përcaktuar në përputhje me kapacitetin e kërkuar dhe me dimensionet e vendit të instalimit, duke garantuar stabilitet strukturor dhe transport të sigurt.
- **Lartësia: 2,400 mm ose 2,600 mm**
Pranimi i dy alternativave të lartësisë rrit konkurrencën dhe mundëson pjesëmarrjen e prodhuesve të ndryshëm, ndërkohë që ruhet i njëjti kapacitet funksional i depozitës.
- **Lidhjet hidraulike: 5 manikota 2" dhe 5/fileto Gas 1½"**
Numri dhe dimensionet e lidhjeve janë përcaktuar për të mundësuar lidhjen e linjave të hyrjes, daljes, shkarkimit, ajrimit dhe instrumenteve të kontrollit, duke siguruar integritet të plotë me rrjetin hidraulik ekzistues.
- **Grykë inspektimi me kapak dhe fashëtë Ø420 mm**
Gryka e inspektimit mundëson kontrollin periodik të gjendjes së brendshme të depozitës, pastrimin dhe mirëmbajtjen sipas kërkesave higjieno-sanitare, pa cenuar integritetin strukturor të saj.
- **Këmbë mbajtëse të stampuara – 3 copë**
Këmbët mbajtëse sigurojnë stabilitetin mekanik të depozitës, shpërndarjen uniforme të ngarkesës dhe krijojnë hapësirën e nevojshme për instalim dhe mirëmbajtje.
- **Materiali: Lllamarinë çeliku ST 37.2 DIN**
Çeliku ST 37.2 sipas standardit DIN është material me karakteristika të mira mekanike

dhe salduese, i përdorur gjerësisht në prodhimin e depozitave metalike për shkak të rezistencës së tij ndaj ngarkesave mekanike dhe jetëgjatësisë së lartë.

- **Trajtimi sipërfaqësor: Zinkim në të nxehtë**

Zinkimi në të nxehtë siguron mbrojtje afatgjatë ndaj korrozionit, rrit jetëgjatësinë e depozitës dhe ul kostot e mirëmbajtjes, veçanërisht në kushte ekspozimi ndaj lagështirës dhe faktorëve atmosferikë.

- **Shfrytëzimi: Vetëm për depozitim uji për përdorim civil ose industrial**

Ky përcaktim garanton që depozita të jetë projektuar dhe prodhuar për ruajtjen e ujit, duke respektuar kërkesat teknike dhe funksionale për këtë qëllim dhe duke shmangur përdorimin e pajisjeve të destinuara për lëngje të tjera.

- **Bojatisja: RAL 7016 me bojë elektrostатike**

Boja elektrostатike siguron mbrojtje shtesë ndaj korrozionit, rrit rezistencën ndaj faktorëve atmosferikë dhe dëmtimeve mekanike, ndërsa ngjyra RAL 7016 siguron uniformitet estetik me pajisjet dhe infrastrukturën ekzistuese të Autoritetit Kontraktor.

Specifikimet teknike të mësipërme janë hartuar mbi bazën e kërkesave funksionale dhe operative të Autoritetit Kontraktor, duke garantuar që depozita e ujit të ofrojë kapacitetin e nevojshëm, qëndrueshmëri strukturore, mbrojtje ndaj korrozionit, lehtësi mirëmbajtjeje dhe jetëgjatësi në përdorim. Këto kërkesa përfaqësojnë standarde minimale teknike dhe nuk janë kufizuese për operatorët ekonomikë, pasi lejojnë ofertimin e çdo produkti që plotëson ose tejkalon parametrat e kërkuar.

Njësia e Prokurimit